



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Municipal Istog
Municipal Istog

Drejtoria për Arsim

05.Nr.706 /18

Datë: 05.11.2018

Drejtoria për Arsim në Komunën e Istogut dukë u bazuar në neni 8 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nenit 35 të Ligjit Nr.04/L-032 Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligjit Nr.03/L-068 Për Arsim në Komunitet e Republikës së Kosovës, dhe në mbështetje të: UA-MPMS, Nr.07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, UA-MASHT, nr.10/2018 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, UA-MASHT, nr.02/2017 Për Vlefshmerinë e Programeve Studimore të Bartësve Privat të Arsimit të Lartë si dhe, references për aprovim të pozitave Nr.13-016-53360 të datës 02.11.2018 shpall këtë:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të punës për mësimdhënës dhe Edukatore .

Në Shfmu "Bajram Curri" në Istog, paralelja e ndarë Cërrc

1. Një mësimdhënës/e për Mësim klasor (1-5).

Në IP "Gzimi Ynë" në Istog

1. Një Edukatore për grup moshat (3-6) zëvendësim deri sa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë.

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurim:

- Formulari i aplikimit (kërkesa) të cilin e plotëson kandidati,
- Rezymeja personale (CV),
- Dokumenti personal (kopja e letërnjoftimit),
- Çertifikata e lindjes
- Kopja e diplomës e vërtetuar, ose certifikata në vend të diplomës e vërtetuar jo me e vjeter së gjashtë muaj gjdo certifikat me e vjeter së gjashtë muaj nga data e diplomimit nuk do të merret parasyshtë.
- Kandidatët të cilët kanë diplomuar jashtë Republikës së Kosovës, duhet ti kenë diplomat e nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë,
- Dëshmitë e rikualifikimeve dhe trajnimeve të akredituara nga MASHT (nëse ka)
- Dëshmia që nuk jeni nën hetime ,
- Dëshmia e përvojës së punës në arsim (nëse ka)

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068 dhe Ligji Nr. 04/L-032) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHT-it (UA Nr. 10/2018) si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Sipas nenit 4 të UA-MASHT,Nr.10/2018 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm për mësimdhënës/e të Mësimit Klasor (1-5) kërkohen këto kualifikime si në vijim:

- Fakulteti i Edukimit-programi fillor
- Fakulteti i Mësuesisë.

Sipas pikes 2 të nenit 3 të UA-MASHT,Nr.10/2018 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm për edukatore për grup moshat (3-6) kërkohen këto kualifikime si në vijim:

- Fakulteti i edukimit-programi parashkollor:
- Shkolla e lartë Pedagogjike-drejtimi për edukatore
- Fakulteti Filozofik-dega e pedagogjisë së përgjithshme
- Fakulteti i Shkencave Sociale-programi perkujdesja dhe mirëqenia e fëmijeve.

Afati i konkursit mbetet i hapur prej datës 05.11.2018 deri më datën 19.11.2018. Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, në hyrje të ndërtesës së Komunës, zyra Nr.100,kati përdhësë dhe dorëzohet i plotësuar së bashku me dokumentacionin përcjellës po në të njëjten zyre.

Dokumentacioni duhet të jetë në kopje,Komisioni i pranimit në rast dyshimi do të kërkon origjinalin në intervistë. Ky dokumentacion shërben deri në përfundim të procedurës së konkursit i njëjti nuk kthehet dhe as nuk ruhet. Dokumentacioni i pa kompletuar dhe ai i cili arrinë pas afatit nuk do të shqyrtohet gjithashtu kandidatët të cilët nuk e plotësojnë qartë dhe saktë formularin e aplikimit(kërkesën) do të refuzohet.

Në testin me shkrim do të ftohen vetëm kandidatet të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriterët bazuar në aktet normative dhe legjislacionin në fuqi,kurse intervistes do ti nenshtrohen vetem kandidatet të cilët arrin të kenë me shumë së 50% të kalushmeris se testit më shkrim.



Drejtori i DKA-së
Hajrush Shoshi